



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/  
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,  
Technology and Innovation*  
Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenit 11 paragrafit 1.5 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 34/18 nëntor 2022), në mbështetje të nenit 4 paragrafit 1.7, nenit 8 dhe shtojcës 7 të Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 09.08.2023, nenit 32, paragrafit 4 të Ligjit 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës të datës 14 shtator 2011, nenit 9 të Udhëzimit administrativ nr. 20/2023 të datës 04.08.2023 për Krijimin e Skemave për Mbështetje Financiare të Studentëve për Ndarjen e Bursave dhe Vendimin nr. 01 - 3480 të datës 16.09.2025 nxjerr:

**K O N K U R S**

**Për ndarjen e bursave për studentët e nivelit bachelor jashtë vendit**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, shpall këtë konkurs duke synuar mbështetjen e shkollimit të studentëve që janë regjistruar apo vijnë studimet në nivelin bachelor në top 100 Universitetet më prestigjioze në botë sipas listës “Times Higher Education”.

- Rangimi i universitetit në këtë listë shërben në procesin e vlerësimit të aplikimeve.
- Shuma maksimale e mbështetjes financiare është deri në 5000 euro ( pesë mijë euro) për student.

**Kushtet dhe kriteret për aplikim dhe përparësitë në konkurrim:**

1. Aplikuesit duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
2. Të kenë të përfunduara studimet parauniversitare;
3. Thirrja vlen vetëm për studentët e nivelit bachelor të cilët ndjekin/fillojnë studimet me prani fizike dhe orar të plotë në kampusin e universitetit pritës;
4. Të mos kenë bursë/mbështetje financiare të plotë nga ndonjë skemë tjetër;
5. Përparësi kanë aplikuesit të cilët kanë gjendje më të dobët socio-ekonomike dhe ata me asistencë sociale;
6. Përparësi kanë studentët të cilët nuk përfitojnë nga ndonjë bursë/mbështetje financiare;
7. Përparësi kanë personat me aftësi të kufizuara në bazë të dëshmisë relevante mbi aftësinë e kufizuar;
8. Në kushte të barabarta, përparësi kanë studentët që më parë nuk kanë qenë përfitues të bursave jashtë vendit përmes Ministrisë gjatë atij viti;
9. Përparësi kanë studentët që kanë përfunduar nivelin paraprak të shkollimit në njërin nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës;

10. Studentët që përfitojnë nga kjo bursë duhet të bashkëpunojnë me Ministrinë për çështje të cilat ndërlidhen me studimet e tyre dhe të raportojnë për suksesin e tyre;
11. Studentët nënshkruajnë Deklaratë të Zotimit që marrin përsipër të promovojnë Kosovën, ndihmojnë në rrjetëzim të studentëve të tjerë dhe mentorojnë të tjerët nëse është nevoja.

### **Forma e aplikimit:**

Aplikimi bëhet nëpërmjet platformës e-Kosova në linkun e shpallur në uebfaqen e MASHTI-t.

### **Dokumentet obligative që duhet të ngarkohen në platformën e-Kosova:**

1. Skanimi i letërnjoftimit;
2. Vërtetimi nga universiteti që aplikuesi/ja është në studimet баçелор në institucionin pritës me prezencë fizike dhe orar të plotë, ku specifikohet niveli i studimeve, fusha e studimit dhe kohëzgjatja e programit (e nënshkruar dhe e vulosur nga Universiteti);
3. Letërpranimin nga institucioni pritës arsimor dhe përgjigjen konfirmuese të studentit/es;
4. Skanimin e diplomës dhe pasqyrën e notave për nivelin paraprak të studimit (të shkollës së mesme të lartë);
5. Për studentët që tashmë janë duke ndjekur studimet баçелор, transkripta e notave nga universiteti pritës (aktuale);
6. Letër motivuese për fushën e studimit dhe nevojën për mbështetje financiare;
7. CV-në;
8. Vërtetim nga universiteti se aplikuesi nuk është pjesë e ndonjë burse/mbështetje financiare. Në rast se studenti ka mbështetje të pjesshme duhet të specifikohet shuma e bursës/mbështetjes financiare dhe/ose çka mbulon ajo bursë;
9. Në rast se studenti nuk përfiton nga ndonjë mbështetje financiare sipas pikës 8 të këtij konkursi, në sistem të ngarkohet një Deklaratë nën betim e nënshkruar nga vet aplikuesi që nuk përfiton nga ndonjë mbështetje financiare e plotë ose e pjesshme nga Republika e Kosovës apo vendi ku studion;
10. Dëshminë/vërtetimin nga organet kompetente mbi adresën/vendbanimin e përhershëm në Kosovë;
11. Dëshmitë relevante të lëshuara nga organet kompetente për asistencën sociale dhe/apo dëshminë e aftësisë së kufizuar sipas kushteve për aplikim dhe përparësive në konkurrim (pika 7 e kushteve dhe kriterëve të aplikimit).
12. Skanimin e Deklaratës së Zotimit (deklaratë personale e nënshkruar nga vet studenti aplikues) që merr përsipër të promovoj Kosovën, ndihmoj në rrjetëzim të studentëve të tjerë dhe mentoroj të tjerët nëse është nevoja.

### **Sqarime shtesë rreth aplikimit:**

- Aplikacioni i pakompletuar do të diskualifikohet;
- Dokumentet duhet të jenë të përkthyer në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, por mund të pranohen edhe dokumentet në gjuhën angleze, nëse janë lëshuar nga institucioni pritës;
- Nuk kanë të drejtë aplikimi, kandidatët të cilët janë përfitues të ndonjë mbështetje financiare nga MASHTI, apo ndonjë institucion tjetër shtetëror;
- Nuk kanë të drejtë aplikimi/përfitimi kandidatët të cilët kanë bursë të plotë studimi;
- Aplikimet pas afatit të specifikuar sipas këtij konkursi nuk pranohen;
- Plotësimi i fushave të aplikacionit në platformën elektronike e-Kosova, është i obligueshëm.

**Sqarime shtesë pas procesit të aplikimit dhe në rast të seleksionimit:**

- Pas përmbylljes së procesit të përzgjedhjes, aplikuesit/et do të nënshkruajnë deklaratën e zotimit të përmbushjes së kushteve dhe obligimeve të kësaj mbështetjeje financiare;
- Studentët përfitues do të sjellin në MASHTI kopjen e letërnjoftimit dhe konfirmimin bankar për llogarinë personale aktive.

Thirrja është e hapur nga data: 03.10.2025 deri më 18.10.2025.